



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



Rregulla ZRRE/Nr.001/2024

**RREGULLA PËR PARIMET PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR SHFRYTËZIM TË
SISTEMIT TË SHPËRNDARJES DHE TAKSAVE PËR KYÇJE NË SISTEMIN E
SHPËRNDARJES**

12 Nëntor, 2024



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji sipas autoritetit të dhëne me Nenin 9 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7., Nenin 15 paragrafin 1 nën paragrafin 1.5, Nenin 25, Neni 26 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, Nenin 47 paragrafin 3 nën paragrafin 3.3 të Ligjit (Nr. 05/L-84) për Rregullatorin e Energjisë, Nenin 36, 37 dhe 38 të Ligjit (Nr. 08/L-258) për Promovimin e Shfrytëzimit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë, në seancën e mbajtur më 12.11.2024, miratoi:

RREGULLA Nr.01/2024 PËR PARIMET PËR PËRCAKTIMIN E TARIFAVE PËR SHFRYTËZIM TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES DHE TAKSAVE PËR KYÇJE NË SISTEMIN E SHPËRNDARJES

PJESA I

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj Rregulle është vendosja e parimeve për përgatitjen e Metodologjisë nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) për përcaktimin e tarifave për shfrytëzim të sistemit të shpërndarjes dhe taksave për kyçje në sistemin e shpërndarjes (tutje: "Parimet").
2. Ky Rregull përcakton:
 - 2.1. Parimet mbi të cilat OSSH harton propozimin mbi Metodologjinë për tarifave për shfrytëzim të sistemit të shpërndarjes ("Metodologjia e përcaktimit të tarifave për shfrytëzim të sistemit të shpërndarjes");
 - 2.2. Parimet mbi të cilat OSSH harton propozimin mbi Metodologjinë për përcaktimin e taksave për kyçje në sistemin e shpërndarjes ("Metodologjia e taksave të kyçjes të rrjetit të shpërndarjes"), dhe
 - 2.3. Procedurën se si këto Metodologji do t'i parashtrihen Zyrës së Rregullatorit të Energjisë (Rregullatorit) për aprovim.



3. Metodologjitë e parashtruara për aprovim duhet të jenë në pajtim me legjislacionin në fuqi, parimet e paraqitura në këtë Rregull, si dhe të jenë përputhje me Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji dhe me Rregullën për vendosjen e të hyrave të lejuara maksimale të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes.
4. Nëse Metodologjitë e propozuara nga OSSH nuk janë në pajtim me parimet dhe Rregullat, atëherë Bordi i Rregulatorit do të kërkojë një arsyetim të plotë dhe të detajuar për këto mospërputhje në mënyrë që të vendosë lidhur me aprovimin e këtyre Metodologjive.

Neni 2

Përkufizimet dhe interpretimi

1. Shprehjet e përdorura në këtë Rregull kanë kuptimet si më poshtë:
 - 1.1 **Aplikuesi** (parashtruesi i kërkesës) - nënkupton një person fizik apo juridik, prodhues apo konsumator vet-prodhues, i cili i kërkon OSSH-së të bëjë kyçjen e re apo për të modifikuar kyçjen ekzistuese në rrjetin e shpërndarjes;
 - 1.2 **Kyçje e cekët** - nënkupton se parashtruesi i kërkesës do të ofroj me shpenzimet e veta apo do të paguaj vetëm ato kosto që shkaktohen nga krijimi i një kyçjeje të re në pikën më të afërt të përshtatshme të rrjetit ekzistues të shpërndarjes të përcaktuar nga OSSH;
 - 1.3 **Kyçje e thellë** - nënkupton se parashtruesi i kërkesës do të ofroj me shpenzimet e veta apo do të paguaj kostot e aseteve të nevojshme për kyçje në pikën më të afërt të përshtatshme të kyçjes në sistemin ekzistues të shpërndarjes plus çfarëdo kostosh indirekte që shkaktohen nga punë të ndërlydhura me përforcimin, zgjerimin apo rikonfigurimin e rrjetit ekzistues e të cilat shkaktohen si pasojë direkte e operimit të pikës së kyçjes;
 - 1.4 **Kyçje e re e thjeshtë** – nënkupton kyçje të re me kushtet e thjeshtuara teknike të përcaktuara nga OSSH;
 - 1.5 **Prodhues** (gjenerues) - nënkupton personin fizik ose juridik që prodhon energji elektrike;
 - 1.6 **Konsumator Prodhues** - nënkupton konsumatorin i cili konsumon energji elektrike nga sistemi por edhe mund të prodhojë energji elektrike që hyn në sistem;



- 1.7 **Ruajtja e Energjisë:** Operatori për ruajtjen e energjisë, në kuptimin e tarifave të rrjetit, trajtohet si konsumator kur blenë energji elektrike dhe si prodhues kur e shet atë.
 - 1.8 **Kapaciteti efektiv** - do të thotë kapaciteti total në secilën pikë të rrjetit i cili është në dispozicion për t'u shfrytëzuar nga shfrytëzuesit pa cenuar kufizimet teknike të operimit të rrjetit. Mund të klasifikohet duke iu referuar çfarëdo kriteri teknik përkatës apo standardeve në fuqi duke përfshirë por duke mos u kufizuar në, kapacitetin aktual të bartjes, kapacitetin e lidhjes së shkurtër, kufijtë e tensionit apo kufijtë e stabilitetit;
 - 1.9 **TU ose tensioni i ulët** - nënkupton tensionin i cili nuk tejkalon 1000 Volt të energjisë elektrike së ndryshueshme;
 - 1.10 **TL** - do të thotë tensioni i shpërndarjes më i lartë se 1000 Volt të energjisë elektrike së ndryshueshme;
 - 1.11 **Taksa standarde për kyçje** - do të thotë taksa që kërkohet nga parashtruesi individual i kërkesës e cila është llogaritur për të pasqyruar koston mesatare për krijimin e kyçjes të ngjashme për atë klasë të parashtruesit të kërkesës;
 - 1.12 **Shfrytëzuesi** – ka kuptimin e njëjtë si ai në Kodin e shpërndarjes.
2. Shprehjet që nuk janë përkufizuar në këtë Rregull kanë kuptimet siç janë përcaktuar me Ligjet e sektorit të energjisë, si dhe Rregullat, Kodet dhe rregullativen tjetër të aprovuar nga ZRRE.

PJESA II

PARIMET E PËRBASHKËTA

Neni 3

Parimet kryesore të strukturës tarifore të rrjetit të shpërndarjes

1. Metodologjia për përcaktimin e tarifave për shfrytëzimin e sistemit të shpërndarjes (DUOS) dhe Metodologjia për përcaktimin e taksave të kyçjes bazohen në parimet kryesore të mëposhtme:
 - 1.1. Përputhshmëria me Ligjin dhe Rregulloret: Tarifat dhe taksat duhet të jenë në përputhje me ligjet dhe rregulloret në fuqi, si dhe me politikat për energji në vend. Kjo siguron që politika e tarifave është e harmonizuar me kërkesat ligjore dhe qëllimet strategjike të sektorit të energjisë.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



- 1.2. Reflektueshmëria e kostos: Tarifat e paguara nga shfrytëzuesi i sistemit të shpërndarjes duhet të pasqyrojnë koston që i shkaktajnë sistemit për të siguruar përdorimin dhe zhvillimin efikas të sistemit, dhe të japin stimuj të duhur për të shmangur kostot e ardhshme;
- 1.3. Jo deformuese: Kostot duhet të mbulohen në mënyra që shmangin deformimet e vendimeve rreth qasjes dhe përdorimit të rrjetit dhe ofertat e tregut;
- 1.4. Mbulimi i kostos: OSSH-të duhet të jenë në gjendje të mbulojnë kostot e bëra në mënyrë efikase përmes tarifave për përdorimin e sistemit të shpërndarjes, taksave për kyçe dhe shërbimeve të rregulluara;
- 1.5. Jo-diskriminuese: Nuk duhet të ketë diskriminim të panevojshëm ndërmjet shfrytëzuesve të sistemit të shpërndarjes ;
- 1.6. Transparenca: Metodologjia për llogaritjen e tarifave për shfrytëzim të sistemit të shpërndarjes duhet të jetë transparente dhe të qasshme për të gjitha palët e interesuara;
- 1.7. Parashikueshmëria: Shfrytëzuesi i sistemit të shpërndarjes të jenë në gjendje të vlerësojë me saktësi kostot e përdorimit të sistemit të shpërndarjes, duke mundësuar investime afatgjata efikase. Megjithatë, për shkak të natyrës në zhvillim të sistemit energjetik, tarifat e rrjetit do të duhet të përshtaten me kalimin e kohës;
- 1.8. Fleksibiliteti: Tarifat duhet të jenë mjaft fleksibile sa për të akomoduar ndryshimet e ardhshme në teknologji, politika dhe kushtet e tregut;
 - a) Stimulimi: Përdorimi i tarifave të sistemit të shpërndarjes duhet të ofrojë sinjale ekonomike për të nxitur sjelljen efikase nga shfrytëzuesi i sistemit të shpërndarjes. Ato duhet të jenë të dizajnuara në mënyrë që të nxisin investime në infrastrukturë dhe përmirësimin e efikasitetit të sistemit të shpërndarjes.
- 1.9. Barazia: Tarifat duhet të synojnë të shpërndajnë kostot midis të gjithë shfrytëzuesit e sistemit të shpërndarjes, duke siguruar që asnjë grup i caktuar të mos bartë një pjesë të kostove padrejtësisht;



- 1.10. Thjeshtësia: Tarifat duhet të jenë të lehta për t'u kuptuar dhe zbatuar. Sa më të thjeshta të jenë, aq më lehtë do t'u përgjigjen shfrytëzuesit e sistemit të shpërndarjes. Kjo përfshin edhe informimin e konsumatorëve mbi mënyrën se si llogariten tarifat dhe si lexohen faturat e tyre të energjisë.
- 1.11. Integrimi i tregut: Tarifat duhet të hartohen në një mënyrë që të mos cenojnë tregun konkurrues të energjisë dhe të jenë koherente me mekanizmat dhe politikat e tjera të tregut.

Neni 4

Konsideratat për zbatimin e parimeve në hartimin e tarifave për përdorimin e sistemit të shpërndarjes

1. Për të zbatuar parimet kryesore për strukturat tarifore siç përshkruhet në nenin 3, metodologjia e hartimit të tarifave për përdorimin e sistemit të shpërndarjes duhet të marrë parasysh sa vijon:
 - 1.1. **Tarifa të qëndrueshme (të orientuara kah e ardhmja)** që nuk janë pengesë për teknologjitë e reja dhe ofertat inovative të tregut nga aktorët e tregut që do të shtojnë vlerën ose do të ulin kostot për konsumatorët, nga aspekti i fleksibilitetit dhe efikasitetit të energjisë.
 - 1.2. **Të ndieshme** ndaj kostove të ndryshme të ofrimit të rrjetit, sic janë kostot e sigurimit të kapacitetit maksimal, kostot e mirëmbajtjes së rrjetit, shpenzimet operative dhe humbjet etj. Secila kosto duhet të reflektohet në mënyrë të përshtatshme përmes strukturave tarifore.
 - 1.3. **Matja neto për vetë-gjenerimin duhet të shmangen**, Vetë-prodhuesit që përdorin rrjetin duhet të përballen me tarifa të drejta dhe reflektuese të kostos në të njëjtën mënyrë si konsumatorët që mbështeten ekskluzivisht në rrjet për furnizimin e tyre me energji.
 - 1.4. **Tarifat e rrjetit janë vetëm një nga mjetet e shumta për të dhënë sinjale çmimi për konsumatorët**, mjete të tjera që mund të sinjalizojnë kongestionin përfshijnë sinjale të bazuara në treg për prokurimin e fleksibilitetit dhe taksat e kyçjes. Kur nevojitet 'përgjigje e fortë', mund të kërkohen mjete të tjera përveç tarifave.



- 1.5. **Qasje koherente** në të gjitha nivelet e tensionit. Vendimet e shfrytëzuesve të sistemit të shpërndarjes se ku të ndërtojnë asete të reja, si të dispeçojnë impiantet dhe kur të konsumojnë energji nuk merren të izoluara. Marrëveshjet në nivelin e transmetimit janë relevante. Koherenca është e rëndësishme dhe arbitrazhi rregullator i bazuar në tarifat e rrjetit duhet të shmanget.
 - 1.6. **Informatat konfidenciale**, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes duhet të ruajë konfidencialitetin e informacionit të ndjeshëm afarist që merr gjatë kryerjes së aktivitetit të tij si dhe duhet të parandalojë informacionet mbi aktivitetet e tij që mund të krijojnë përparësi komerciale nëse zbulohen në mënyrë diskriminuese.
 - 1.7. **Të gjitha strukturat tarifore reflektojnë objektiva të shumëfishta të cilat duhet të balancohen.** Këto mund të evoluojnë me kalimin e kohës; Ato mund të ndryshojnë nga vendi në vend;
 - 1.8. **Hartimi i tarifave** kërkon planifikim të kujdesshëm dhe ka nevojë për menaxhim efektiv të tranzicioneve.
2. Pavarësisht nga parimet kryesore të reflektimit të kostos në strukturën e tarifave dhe tarifave, OSSH mund të përcaktojë tarifat mesatare ose të standardizuara të kyçjes dhe tarifat DUOS për çdo klasë të përdoruesve ku:
- 2.1. Përdoruesit brenda asaj klase, bazuar në karakteristikat e tyre të kërkesës, janë gjerësisht të ngjashëm për sa i përket kostove që i imponojnë OSSH-së (duke marrë parasysh vëllimet përkatëse, faktorët e ngarkesës, formën e ngarkesës, kushtet e ndërprerjes, vendndodhjen e objekteve ku ofrohen shërbimet, datën dhe kohëzgjatjen e ndonjë marrëveshje mbi sistemin, dhe çdo informacion tjetër relevant);
 - 2.2. Vendosja e një çmimi specifik për përdoruesit brenda asaj klase do të çonte në kosto më të larta administrative për OSSH-në pa ndonjë përfitim materialisht të kompensueshëm për përdoruesit në aspektin e transparencës;
 - 2.3. Tarifat e diferencuara, përkatësisht tarifat për shërbimet e shfrytëzuesve të sistemit të shpërndarjes përfshijnë pagesat që lidhen me pagesat mujore fikse dhe pagesat për kapacitet dhe energji për klientët sipas niveleve të tensionit; dhe
 - 2.4. Një tarifë i tillë mesatare nuk ka gjasa të krijojë ndonjë pengesë për konkurrencën.



PJESA III – METODOLOGJIA E PËRCAKTIMIT TË TARIFAVE PËR SHFRYTËZIM TË SISTEMIT TË SHPËRNDARJES

Neni 5

Metodologjia e përcaktimit të tarifave : kërkesat minimale

1. Metodologjia e përcaktimit të tarifave duhet t'u mundësojë shfrytëzuesve të sistemit të shpërndarjes që të bëjnë një vlerësim të arsyeshëm mbi tarifën e aplikueshme për shfrytëzim të sistemit të shpërndarjes dhe duhet të përfshijë:
 - 1.1. Bazën mbi të cilën do të llogariten tarifën për shfrytëzim të sistemit të shpërndarjes;
 - 1.2. Bazën mbi të cilën do të bëhen tarifën e veçanta për kapacitetin në qarqet e sistemit të shpërndarjes;
 - 1.3. Listën e çfarëdo tarifë që mund të kërkohet për ofrimin dhe instalimin e njehsorëve, përfshirë njehsorët kontrollues, apo ndonjë sistem elektrik në pikat hyrëse apo dalje, të cilat ndihmojnë dhe janë të domosdoshme për lejimin e shfrytëzimit të sistemit dhe për mirëmbajtjen e njehsorëve dhe sistemeve të tilla;
 - 1.4. Kriteret mbi të cilat merret vendimi i OSSH-së për të refuzuar përkohësisht qasjen në sistem, të cilat duhet të jenë objektive, dhe teknikisht e ekonomikisht të arsyetuara.

Neni 6

Baza e përcaktimit të tarifave

1. Në përcaktimin tarifave për shfrytëzuesit për përdorimin e sistemit në kuptim të Nenit 5.1, nënparagrafi 1.1, OSSH duhet të merr parasysh:
 - 1.1. kostot afatmesme të mirëmbajtjes së një sistemi të sigurt dhe të besueshëm në mënyrë që të përmirësohet parashikueshmëria, stabiliteti dhe pasqyrimi i çmimeve në aspektin afatgjatë;
 - 1.2. sigurinë e rrjetit, digjitalizimin dhe shërbimet e fleksibilitetit.
2. Në hartimin e Metodologjisë për përcaktimin e tarifave për shfrytëzim të sistemit, OSSH duhet të merr parasysh kostot afatgjate, margjinale, kostot e shmangura të rrjetit që shkaktohen nga gjenerimi i shpërndarë dhe nga masat për menaxhimin e anës së kërkesës.



3. Metodologjia për përcaktimin e tarifave për shfrytëzim të sistemit të shpërndarjes, duhet të inkurajojë mekanizmat për të përmirësuar efikasitetin e energjisë dhe menaxhimin nga ana e kërkesës, siç janë tarifimet me opsionin e ndërprerjes (interruptible tariffs) dhe tarifimet e kohës së përdorimit.
4. Bazat tarifore për DUOS mund të jenë:
 - 4.1. Bazuar në energji;
 - 4.2. Bazuar në fuqi;
 - 4.3. Shuma paushall.

Neni 7

Ndarja e kostos për shfrytëzim të sistemit

1. Metodologjia gjatë ndarjes së kostos për shfrytëzim të sistemit duhet të respektojë parimet vijuese:
 - 1.1. OSSH duhet të mbulojë kostot fikse (nëpërmjet tarifave të kapacitetit, apo tarifave për energji) duke ndarë kostot me të gjithë përdoruesit e sistemit, duke përfshirë:
 - 1.1.1. **Konsumatorët** që përdorin sistemin e shpërndarjes vetëm për furnizimin e tyre me energji;
 - 1.1.2. **Prodhuesit (gjeneruesit)** që injektojnë ekskluzivisht energji;
 - 1.1.3. **Konsumatorët dhe objektet e ruajtjes** – që përdorin sistemin e shpërndarjes për furnizim dhe injektim të energjisë.
 - 1.2. OSSH duhet të mbulojë kostot variabile për shfrytëzim të sistemit përmes tarifave për energji;
 - 1.3. Tarifimet duhet të përcaktohen në mënyrën e cila mundëson reflektimin e kostos për ofrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të shpërndarjes, të disponueshëm në nivele të ndryshme të tensionit;
 - 1.4. Nga shfrytëzuesit nuk duhet të pritet që të paguajnë për kostot kapitale, operative apo të mirëmbajtjes në lidhje me asetet të cilat nuk i shfrytëzojnë;



- 1.5. Tarifat duhet të pasqyrojnë kostot që i shkaktohen, ose që vlerësohet se i shkaktohen sistemit nga shfrytëzuesi apo nga klasa e shfrytëzuesit në kohën e pikut (kërkesës më të lartë) në sistem;
 - 1.6. OSSH për kryerjen e aktiviteteve të rregulluara të energjisë duhet të ndajnë llogaritë e tyre të brendshme për këto aktivitete në formë të tillë sikur këto aktivitete të zhvilloheshin nga ndërmarrje të veçanta me qëllim që të shmanget diskriminimi, subvencionet e ndërsjella dhe shtrembërimi i konkurrencës. Ato gjithashtu duhet të mbajnë llogari, të cilat mund të jenë të konsoliduara, për aktivitete tjera të energjisë elektrike jo të rregulluara dhe duhet të sigurojnë se këto llogari janë audituar.
2. Në alokimin e kostove të përdorimit të sistemit, OSSH duhet të zhvillojë tarifën për injektimin e energjisë dhe tarifën për furnizimin me energji në nivele të përshtatshme bazuar në kostot aktuale të përdorimit të sistemit të shpërndarjes.

Neni 8

Tarifat e injektimit për palët që injektojnë energji në sistemin e shpërndarjes

1. Prodhuesit (gjeneruesit), objektet e ruajtjes së energjisë dhe konsumatorët vet-prodhues mund të jenë subjekt i tarifave të injektimit për përdorimin e sistemit të shpërndarjes për të injektuar energjinë e tyre në sistem.
2. Tarifat e injektimit do të vendosen në të njëjtat parime dhe elemente të përcaktuara në nenin 3 të këtij Rregulli, përkatësisht:
 - 2.1. Gjatë përcaktimit të tarifave të injektimit, OSSH do të marrë parasysh vetëm kostot e bëra nga sistemi për shkak të injektimit të energjisë.
 - 2.2. **Tarifat e injektimit për prodhuesit** - duhet të jenë të bazuara në fuqi (të shprehura në €/kW) ose në shumën e përgjithshme, për sa kohë që ato pasqyrojnë kostot e ofrimit të shërbimeve të infrastrukturës së shpërndarjes për përdoruesit e rrjetit, mund të jenë të përshtatshme, për të pasqyruar më mirë faktorët e tyre kryesorë të kostos. Kostot që nuk lidhen as me kapacitetin, as me energjinë, por në vend të kësaj me numrin e përdoruesve ose matësve të rrjetit (siç janë faturimi, matja ose kostot administrative), në mënyrë ideale duhet të mbulohen nëpërmjet tarifave fikse.



2.3. **Objektet e ruajtjes së energjisë dhe konsumatorët vet-prodhues** – duke marrë parasysh siç duhet efektin e kundërbalancimit të kostos së mundshme dhe ndikimin e përgjithshëm të kostos në rrjet. Në këtë kontekst, ku aplikohen tarifa vëllimore, **matja neto duhet të shmanget**. Ajo nuk reflekton koston dhe i zhvendos kostot tek përdoruesit që vetëm injektojnë ose vetën tërhiqen nga rrjeti.

2.4. Tarifat për shfrytëzim dhe taksat për kyçje duhet të jenë të jenë të përshtatshme për të garantuar që investitorët dhe përdoruesit e shërbimeve të kenë mundësi të barabarta dhe të drejtë për tu kyçur në sistem.

Neni 9

Përgjashtimet, zbritjet për prodhuesit, objektet e ruajtjes dhe konsumatorët vet-prodhues

Prodhuesit, objektet e ruajtjes së energjisë dhe konsumatorët vet-prodhues mund të përjashtohen nga tarifat e injektimit ose të marrin një zbritje, siç vendoset nga Rregullatori ose ndonjë organ tjetër qeveritar i autorizuar për të marrë vendime të tilla.

Neni 10

Kostot e mbulueshme

1. Deri në përmasat e të cilave kostoja e tillë mund t'i ngarkohet shfrytëzuesit (ose në rast të tarifave mesatare një klase të shfrytëzuesve), tarifat për shfrytëzim të sistemit mund të përcaktohen për të mbuluar:

1.1. Kostot kapitale dhe të punës për mirëmbajtjen e një sistemi të sigurt dhe të besueshëm, në përputhje me standardet kombëtare në fuqi që vlejné për bartjen e energjisë elektrike nga pika hyrëse e shfrytëzuesit deri te pika dalëse, dhe atë deri në masën ku këto kosto nuk mund të rikthehen nga ndonjë tarifë tjetër;

1.2. Kostot e mirëmbajtjes së tensionit dhe frekuencës në kuadër të kufijve kombëtar në fuqi;

1.3. Kostot e arsyeshme të humbjes në shpërndarje (si teknike ashtu edhe komerciale) në formën e furnizimeve shtesë të nevojshme për t'i mbuluar këto humbje në shpërndarje (siç përcaktohen nga Rregullatori);

1.4. Kostot e ofrimit, instalimit dhe mirëmbajtjes së njehsorëve relevant, deri në masën ku këto kosto nuk rikthehen nga ndonjë tarifë tjetër; dhe



- 1.5. Çfarëdo kosto tjetër të cilën, kohë pas kohe, Rregullatori mund ta aprovojë si të mbulueshme përmes sistemit të tarifave ashtu siç është përcaktuar në Rregullën për të Hyrat e OSSH-së.
- 1.6. Operatori i rrjetit do të marrë në konsideratë vetëm ato kosto apo komponentë të tyre që kanë të bëjnë me marrjen nga të tretët të shërbimeve të nevojshme për kryerjen e aktivitetit njësoj sikur t'i kryente vetë ato. Operatori i rrjetit duhet që për secilën nga këto kosto të paraqesë dokumenta dhe prova.
- 1.7. Nëse ndodhin shpenzime apo të ardhura të jashtëzakonshme, ato duhet t'i raportohen pa vonesë rregullatorit.
- 1.8. Llogaritja e kostove të rrjetit të shpërndarjes bazohet në dokumenta të mbajtura mbi baza vjetore për këtë qëllim dhe që lidhen me aktivitetin e shpërndarjes.

Neni 11

Energjia elektrike dhe bilancet e energjisë elektrike

1. Bilanci i energjisë elektrike të OSSH-së për vitin bazë do të përgatitet nëpërmjet përlogaritjes së shumës totale të energjisë në GWh të distribuuar në rrjetin e shpërndarjes gjatë vitit bazë. Energjia totale e marrë duhet të ndahet në:
 - 1.1. energji elektrike e tek FSHU dhe furnizuesit komercial
 - 1.2. humbjet e energjise elektrike në rrjetin e shpërndarjes

Neni 12

Oferta e kushteve për shfrytëzim të shërbimeve të sistemit

1. Në kërkesën e parashtruar nga ndonjë Aplikues, OSSH duhet të ofrojë marrëveshje për ofrimin e shërbimeve të shfrytëzimit të sistemit.
2. Oferta në paragrafin 1 duhet të bëhet jo më vonë se tridhjetë [30] ditë kalendarike pas pranimit të kërkesës për kyçje në rrjetin e shpërndarjes.
3. Oferta për të vënë në dispozicion shfrytëzimin e shërbimeve të sistemit duhet të përcaktojë:



- 3.1. pikën e kyçjes;
 - 3.2. kapacitetin në disponim;
 - 3.3. të gjitha shërbimet tjera të cilat mund të kërkohen me kërkesë; dhe
 - 3.4. çmimet që duhet të paguhen për shërbimet e tilla.
4. Çfarëdo marrëveshje apo ofertë e bërë nga OSSH-ja duhet të jetë në pajtim me Ligjet e Kosovës, Kodin e shpërndarjes, licencën apo ndonjë rregull tjetër të lëshuar nga Rregullatori.

PJESA IV

KYÇJA NË SISTEM

Neni 13

Metodologjia e përcaktimit të taksave për kyçje: kërkesat minimale

1. Metodologjia e përcaktimit të taksave duhet të përgatitet në mënyrë që t'i mundësojë shfrytëzuesve të sistemit që të bëjnë një vlerësim të arsyeshëm mbi taksat e aplikueshme të kyçjes.
2. Metodologjia e përcaktimit të taksave duhet të përfshijë:
 - 2.1. forma e ekzemplarëve ku janë të cekura materialet e nevojshme për kyçje dhe çmimet e materialeve (përfshirë koston për kryerjen e punëve dhe ofrimin dhe instalimin e linjave elektrike, impianteve apo njehsorëve), të cilat mund të kërkohen për qëllime të kyçjeve (në pikat hyrëse dhe dalëse) të sistemit të shpërndarjes për të cilat mund të paguhen taksat për kyçje dhe, sipas mundësisë, përfshijnë ngarkesa indikative kundrejt çdo pike të cekur në listë ose (nëse kjo nuk është e mundur) bazën mbi të cilën këto ngarkesa do të llogariten;
 - 2.2. bazat mbi të cilën do të llogariten taksat kundrejt zgjerimit apo përforcimit të sistemit të shpërndarjes të cilën OSSH-ja vlerëson, në mënyrë të arsyeshme, se janë të domosdoshme për t'i ofruar një kyçje parashtruesit të kërkesës pa rrezikuar stabilitetin apo sigurinë e sistemit, apo cilësinë e furnizimit të shfrytëzuesve ekzistues të sistemit;



- 2.3. bazën mbi të cilën do të llogariten taksat ku sigurimi i linjave elektrike apo sistemit që duhet të instalohen janë të kapacitetit më të madh sesa që nevojitet për nevoja të parashtruesit të kërkesës;
- 2.4. bazën mbi të cilën do të llogariten taksat për mirëmbajtje dhe riparim të linjave të energjisë elektrike, sistemeve apo njehsorëve të instaluar për qëllime të sigurimit të kyçjes;
- 2.5. bazën mbi të cilën do të llogariten taksat në raport me de-energizimin e kyçjes së konsumatorit, çkyçjen nga sistemi i shpërndarjes të OSSH-së dhe largimin e linjave elektrike, sistemit dhe njehsorëve pas çkyçjes.
- 2.6. kriteret mbi të cilat merret vendimi i OSSH-së për të refuzuar përkohësisht qasjen në sistem, të cilat do të jenë objektive dhe teknikisht e ekonomikisht të arsyeshme.
3. Për t'iu shmangur dyshimit, në rastet kur asetet janë paguar nga kontributet e konsumatorit për koston e kyçjes, Baza e Rregulluar e Aseteve nuk do të përfshijë kontributet e konsumatorëve.
4. Metodologjia duhet të përfshij një listë të të gjitha informatave të kërkuara për kyçje në sistemin e shpërndarjes, përfshirë edhe formularët të cilët parashtruesit e kërkesës duhet t'i plotësojnë. Në rast të kyçjeve komplekse, OSSH mund të kërkojë informata shtesë nga parashtruesi i kërkesës.
5. Metodologjia e aprovuar duhet të publikohet në ueb faqen e OSSH-së dhe duhet të jetë lehtësisht e qasshme, ndërsa kopjet fizike duhet t'iu vihen në dispozicion pa pagesë parashtruesve të kërkesave të cilat nuk kanë qasje në media elektronike.

Neni 14

Kyçja e gjeneratorit dhe konsumatorit vet-prodhues

1. Çdo person fizik apo juridik, gjenerator/prodhues apo konsumator vet-prodhues mund të aplikojë për kyçje të re apo modifikim të kyçjes ekzistuese në Sistemin e Shpërndarjes, me qëllim të furnizimit me energji elektrike apo gjenerimit të energjisë elektrike.
2. OSSH-së i lejohe të kërkojë pagesë, sipas Metodologjisë së Taksave për Kyçje e cila do të miratohet nga Rregullatori, me qëllim të mbulimit të kostove që kanë të bëjnë me vlerësimin e kërkesës së parashtruar nga gjeneratorët për kyçje në sistemin e shpërndarjes.



3. OSSH duhet t'ju siguroj qasje në rrjetin e shpërndarjes, sipas parimeve rregulluese, transparente dhe jodiskriminuese për shfrytëzuesit e sistemit apo kategorive të shfrytëzuesve të sistemit, në veçanti duke mos i favorizuar vartësit apo aksionarët e tij.
4. OSSH propozon për aprovim tek Rregullatori një procedurë të thjeshtuar të kycjes në rrjet të konsumatorëve vet-prodhues nga burimet e ripërtërishme, gjeneratorëve dhe projektet demonstruese deri në 200 kW fuqi të instaluar. Duke përfshirë këtu përcaktimin e parametrave dhe kriterëve teknike për përcaktimin e kapacitetit të kyqjes në rrjet.

Neni 15

Taksat për kyqje

1. Taksat e kyqjes do të vlejné për të gjithë aplikuesit, pa dallim, dhe struktura e tyre do të mundësojë mbulimin e shpenzimeve për punët e kryera nga OSSH, si për kyqje të re ashtu edhe për modifikimet ekzistuese.
2. Do të ketë dy lloje të taksave:
 - 2.1. taksa shërbim të kyqjes;
 - 2.2. taksa për kryerje të punimeve, nëse punët për ndërtimin e kyqjes kryhen nga OSSH.
3. Aplikuesi ka të drejtë të angazhoj një kontraktues të licencuar për punët e ndërtimit, nën mbikëqyrjen e OSSH-së.
4. Në rast se kërkesa për kyqje të re e tejkalon kapacitetin e disponueshëm të rrjetit, atëherë Aplikuesi do të paguajë taksën për shërbim të kyqjes dhe taksën për kapacitet por vetëm për pjesën e përforcuar.
5. Kur kërkesa për kyqje të re e aplikuesit shtëpiak individual e tejkalon kapacitetin e disponueshëm të rrjetit, mirëpo kjo kërkesë është më e vogël se 5 kW, atëherë aplikuesi nuk duhet të ngarkohet për kapacitetin e tij të nevojshëm. Në këtë rast, OSSH do të bëjë rritjen e kapacitetit të rrjetit dhe kostot që ndërlihen me të do të mbulohen përmes tarifave për shfrytëzimin e rrjetit.
6. Taksat për kyqje të thella do të aplikohen vetëm në rastet kur OSSH-ja nuk e ka në planin zhvillimor zgjerimin e rrjetit në pikën ku duhet të kyçet konsumatori.



Neni 16

Përcaktimi i taksave për kyçje

1. OSSH parashtron Metodologjinë për përcaktimin e taksave për kyçje për aprovim të Rregullatori në përputhje me Rregullën për të Hyrat e OSSH-së me parimet e përcaktimit të taksave.
2. Taksa e kyçjes përbëhet nga taksa standarde (fikse) për shërbim të kyçjes, taksa për kapacitet dhe taksa e punës për ndërtim të rrjetit elektrik (nëse punët kryhen nga OSSH).
3. Kostot të cilat përbëjnë taksën e kyçjes përfshijnë shqyrtimin e kërkesës për kyçje, përgatitjen e ofertës për kyçje si dhe zgjidhjes teknike, projektin e kyçjes dhe implementimin e tij, duke përfshirë kostot e kyçjes së aseteve si dhe shpenzimet për punët që lidhen me instalimin, testimin dhe futjen në punë të aseteve të kyçjes.
4. Pas aprovimit të Metodologjisë, brenda tridhjetë (30) ditë kalendarike, OSSH duhet të parashtojë për aprovim në rregullator deklaratën e taksave për kyçje të llogaritura në përputhje me Metodologjinë.
5. OSSH-ja duhet t'i parashtojë një deklaratë të taksave në rregullator për aprovim, në përjashtim të taksave indikative (nëse propozohet ndryshim i taksave apo jo) të paktën një herë në vit.
6. Taksat indikative të parapara në metodologji duhet të jenë të bazuara në çmimet e tregut dhe, duhet ti dërgohen rregullatorit vetëm për informim dhe duhet të publikohen në faqen elektronike të OSSH dhe ZRRE.
7. Rregullatori do t'i aprovoj taksat apo refuzojë brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve kalendarike nga data e dërgimit të taksave në rregullator.

Neni 17

Oferta e kushteve për kyçje

1. Në rastet kur OSSH ka pranuar kërkesë formale për kyçje me të gjitha informatat e nevojshme sipas Metodologjisë së aprovuar për përcaktim të taksave, ai jep ofertë formale për të kyçur parashtruesin e kërkesës brenda afatëve kohore të parapara me Rregullën për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me Energji. Brenda dhjetë (10) ditëve kalendarike nga kërkesa për kyçjen e Aplikuesit, OSSH mund të njoftojë Aplikuesin që kërkohen informata shtesë dhe në një rast të tillë afati korrespondues për përgatitjen e Ofertës për Kyçje do të shtyhet për periudhën



kohore të dorëzimit të informatave të kërkuara shtesë. Me kërkesë të konsumatorit për një kyçje të re apo të modifikuar, OSSH-ja duhet të ofrojë një para-llogari indikative dhe jo-obliguese për të ndihmuar konsumatorin që të hartojë buxhetin lidhur me kostot financiare të këtij projekti.

2. Oferta formale duhet të përmbajë kushtet teknike për kryerjen e kyçjes përkatëse, kapacitetin e kyçjes, kostot e studimit të fizibilitetit (nëse është i nevojshëm), përcaktimin e kryerjes së punëve, nëse ajo do të bëhet nga OSSH apo nga një kontraktues i licencuar, definimi i punëve të nevojshme varësisht nga lloji i kyçjes, lejet përkatëse apo autorizimet lidhur me të drejtën e shfrytëzimit të pronës, të gjitha taksat relevante, si taksa standarde, taksa për kapacitet, apo taksa për punët e kryera nga OSSH, instalimin e matësve elektrik dhe pajisjeve tjera për mbrojtje dhe monitorim, specifikimin teknik, kushtet e transferimit të aseteve mes aplikuesit dhe OSSH, në rastet kur kërkohet ky transferim, definimi i periudhës kohore maksimale për punët që kryhen qoftë nga OSSH apo nga kontraktuesi i licencuar.
3. Nëse pas pranimit të ofertës formale nga Aplikuesi OSSH kërkon ndryshim të kushteve të kyçjes atëherë OSSH bart kostot përkatëse duke përfshirë koston e optimizimit, forcimit dhe zgjerimit të sistemit të shpërndarjes.
4. Nëse gjatë konsultimeve ndërmjet OSSH dhe Aplikuesit për kyçje aplikacioni konsiderohet të jetë kompleks, atëherë OSSH mund të kërkojë të kryhet një studim fizibiliteti me qëllim që të analizohen më shumë opsione për kyçje si dhe të ketë vlerësim të duhur të kostove për çdo opsion sipas nevojës.

Neni 18

Obligimet dhe të drejtat e aplikuesit

1. Nëse Aplikuesi pranon ofertën e OSSH-së për tu kyçur në Sistemin e Shpërndarjes, ai duhet ta pranojë atë ofertë në pajtim me të gjitha kushtet e saj, përfshirë: kushtet e zgjidhjes teknike, mundësinë që OSSH të bëjë implementimin e rrjetit të ri si edhe mundësinë e transferimit të aseteve të Aplikuesit të OSSH. Në rastet e refuzimit nga Aplikuesi për transferin e aseteve tek OSSH, atëherë pika matëse do të vendoset në pikën e kyçjes së OSSH.
2. Pas pranimit të Ofertës për Kyçje, Aplikuesi nënshkruan marrëveshjen e ndërtimit dhe bënë pagesën sipas Ofertës për Kyçje të OSSH, brenda afatit prej tridhjetë ditësh (30) nga dorëzimi i Ofertës së Kyçjes. Marrëveshja e ndërtimit e nënshkruar nga të dyja palët do të krijojë një marrëveshje ligjërish të detyrueshme midis Aplikuesit dhe OSSH-së.



3. Nëse Aplikuesi nuk pajtohet me kushtet e ofruara nga OSSH ose me trajtimin e kërkesës për kyçje të OSSH-së, Aplikuesi mund të iniciojë një ankesë pranë OSSH sipas Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë. Nëse Aplikuesi ende nuk pajtohet me veprimet e OSSH-së ka të drejtë të iniciojë ankesë pranë Rregullatorit.
4. Gjatë periudhës për përgatitjen ofertës për kyçje, kapaciteti në sistemin e shpërndarjes do të konsiderohet ngarkesë e rezervuar për Aplikuesin.

Neni 19

Refuzimi i përkohshëm i kërkesës

OSSH mund të refuzoj të kyçë një Aplikues përkohësisht, vetëm nëse ajo kyçje është në kundërshtim me dispozitat e Ligjeve, Rregullave dhe Kodeve në fuqi. Në rast të refuzimit të kyçjes, OSSH lëshon dhe dërgon tek Aplikuesi një njoftim në formë të shkruar dhe paraqet arsyen e refuzimit të përkohshëm brenda periudhës që nuk tejkalon tridhjetë (30) ditë kalendarike prej datës së dërgimit të aplikacionit.

Neni 20

Rastet e veçanta

OSSH përmes metodologjisë së kyçjes do të përcaktojë të gjitha aspektet që lidhen me rastet e veçanta, varësisht nga specifikat e aplikimit, që do të mund të përfshijë kyçjet e përkohshme për objektet në ndërtim e sipër apo kyçjet që lidhen me objektet e ndryshme afariste, duke përfshirë edhe qendrat tregtare.

Neni 21

Përparësia e kyçjes për pikën e njëjtë të kyçjes

Kërkesa për kyçje për pikën e njëjtë të kyçjes, kur dy apo më shumë konsumator kërkojnë kyçje në pikën ku kapaciteti rezervë është i pamjaftueshëm apo ka kufizime të tjera në rrjet të cilat pengojnë kyçjen e të gjithë Aplikuesve në rrjet, atëherë zbatohet parimi “i pari për nga koha, i pari për nga e drejta” ashtu që Aplikuesi i parë shërbehet, kurse për Aplikuesit tjerë OSSH do të bëjë propozim për kyçje në një pike tjetër.



Neni 22

Bashkëpunimi i OSSH dhe OST për kyçjet e thella

Në rastet e realizimit të kyçjeve ku përfshihet edhe zgjerimi i sistemit të transmetimit, taksat do të aplikohen si për rrjetin e shpërndarjes ashtu edhe për rrjetin e transmetimit, përderisa OST dhe OSSH do të koordinohen rreth shpërndarjes së kostove në mënyrë adekuate.

Neni 23

Të Drejtat e Kyçjes së Re

1. Metodologjia e përgatitur nga OSSH do të definojë të gjitha veprimet që lidhen me të drejtat e kyçjes së re, duke marrë për bazë parimet e përvijuara në këtë dokument, si dhe do të marrë parasysh të drejtat e shfrytëzimit, servitutit dhe të drejtat e pronësisë, të cilat do të aplikohen në tërësi në pajtim me dispozitat përkatëse të Ligjit për Energjinë.
2. Konsumatorët që kanë në pronësi të tyre pika të kyçjes, përfshirë aparatat matëse, mund t'i transferojnë asetet e tyre tek operatorët e sistemit pa asnjë kompensim por në gjendje të rregullt teknike, përderisa stabilimentet energjetike, si linjat, shtyllat, transformatorët, e kështu me radhë, nuk mund të jenë në posedim privat përpos nëse përdoren vetëm nga një konsumator. Në rast të kyçjes së më shumë konsumatorëve, asetet kalojnë në OSSH pa asnjë kompensim. Mirëmbajtja e kyçjeve bëhet sipas çmimoreve të miratuara nga ZRRE, ndërsa mirëmbajtja e kyçjes së thellë është përgjegjësi e OST dhe OSSH.

Neni 24

Kompensimi i Aplikuesit të Parë nga Aplikues të Rinj

1. Asetet të cilat janë ndërtuara para hyrjes në fuqi të metodologjisë së kyçjes dhe ato të ndërtuara për furnizim të objekteve kolektive nuk do të kompensohen.
2. Aplikuesi i/e parë që cili ka investuar në ndërtimin e aseteve për kyçje, do të njoftohet nga OSSHja për mundësinë dhe mënyrën e kompensimit, si dhe për vlerën e aseteve të tyre në momentin e kyçjes në sistemin e shpërndarës.
3. Në momentin e investimeve nga Aplikuesi i parë, OSSH do të bëjë vlerësimin e aseteve të investuara në bazë të çmimeve aktuale të aprovuara nga ZRRE.
4. OSSH, përmes metodologjisë së kyçjes, dhe mbi bazën e parimeve të përcaktuara këtu, do të operacionalizojë aspektet e aplikimit të taksave në rastet e kyçjes së aplikuesve të ri në asetet të



cilat janë paguar nga aplikuesi i mëhershëm, si dhe çështjet e transferimit të aseteve në lidhje me këtë qëllim.

5. Kompensimi i aplikuesit të parë nga aplikuesit tjerë do të bëhet përmes OSSH-së.
6. Mënyra dhe vlera e kompensimit do të përgatitet nga OSSH dhe do të jetë pjesë e Metodologjisë së Taksave për Kycje.

PJESA V

DISPOZITAT E PËRGJITHSHME

Neni 25

Gjuha zyrtare

Ky Rregull publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës. Në rast të mospërputhjes ndërmjet versioneve, do të mbizotërojë versioni në gjuhën shqipe.

Neni 26

Ndryshimet/Plotësimet

1. ZRRE ka të drejtë të ndryshojë ose modifikojë çdo dispozitë të kësaj Rregulle.
2. Procedura e ndryshimit apo plotësimit të kësaj Rregulle do të jetë e njëjtë si për miratimin e saj.

Neni 27

Shfuqizimi

Ky Rregull shfuqizon "Rregullën Nr. 01/2022 mbi Parimet e Përcaktimit të Ngarkesave të Shpërndarjes të aprovuara nga Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji.

Neni 28

Interpretimi

Nëse ka paqartësi rreth dispozitave të kësaj Rregulle, Bordi i ZRRE-së, do të nxjerrë informacione shpjeguese.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo


ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE




Neni 29
Hyrja në fuqi

1. Ky Rregull hyn në fuqi në ditën e miratimit nga Bordi i ZRRE-së.
2. Rregulla publikohen në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.


Bordi i ZRRE-së:




Ymer Fejzullahu, Kryesues




Lutfije Dervishi, Anëtare



Gani Buçaj, Anëtar



Arta Isufi, Anëtare



Adnan Preniqi, Anëtar